



KOMUNIKATË PËR SHTYP

14 mars 2018

KSC2-18

## **Shpallen emrat e parë në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe Listën e Mbrojtësve të Viktimave të Dhomave të Specializuara të Kosovës**

Sot më 14 mars 2018, Dhomat e Specializuara të Kosovës publikuan Listat e Mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave, ose të cilitdo personi tjetër që gëzon të drejtën e përfaqësimit juridik, në përputhje me [Ligjin](#) për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe [Direktivën për Mbrojtësit](#).

Listat përmbajnë emrat e 40 juristëve që janë pranuar në Listat e Mbrojtësve dhe tashmë mund të përfaqësojnë të dyshuar, të akuzuar, një grup viktimash ose këdo tjetër që gëzon të drejtën e përfaqësimit juridik në procedurat para Dhomave të Specializuara.

Me këtë rast, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, deklaroi: “Unë i përgëzoj të gjithë avokatët që tashmë janë pranuar në Listat e Mbrojtësve. Kushtet e rrepta për pranim në Listat e Mbrojtësve sigurojnë përfaqësim të efektshëm dhe profesional ligjor përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës për të akuzuarit dhe viktimat, duke dhënë kështu një kontribut të mëtejshëm për integritetin e administrimit të drejtësisë nga ana e Dhomave të Specializuara.

Që nga nëntori 2017, Zyra e Mbrojtjes dhe Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave kanë marrë kërkesa të shumta. Vlerësimi i kërkesave dhe procesi i pranimit të mbrojtësve është kryer në mënyrë sistematike, të barabartë për të gjithë kandidatët dhe në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit dhe kriteret e pranimit të përcaktuara në këtë Direktivë. Emrat e të gjithë mbrojtësve **të pranuar deri më sot** gjenden në [tabelën](#) në faqen e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Internet.

Listat e Mbrojtësve do të aktualizohen në vijimësi. Me vijimin e procesit të vlerësimit, në Listat e Mbrojtësve do të pranohen edhe kandidatët të tjerë, që do të thotë se **procesi mbetet i hapur**.

Hollësitë në lidhje me pranimin mund t’i gjeni në [Udhëzuesin](#) në lidhje me plotësimin e formularit të kërkesës për pranim në Listat e Mbrojtësve.

### **KONTAKTI:**

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun e Dhomave të Specializuara në:  
[mediaKSC@scp-ks.org](mailto:mediaKSC@scp-ks.org), numri i telefonit: +31(0)6 249 21 036

Për më shumë informacion në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës, vizitoni: [www.scp-ks.org](http://www.scp-ks.org)